



The project "ALTER - Active Local Territories for Economic development of Rural Areas" is supported by European Commission



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

FTESË

Sesion informimi

Programi i Grantit për Ngritjen e Kapaciteteve të Shoqërisë Civile dhe Advokimin

Thirrje për projekt-propozime

Në kuadër të Thirrjes për Grante të shpallur nga Rrjeti Serb për Zhvillimin Rural, në emër të konsorciumit të partnerëve: Fondacioni për Zhvillimin e Turqisë, Turqi; Rrjeti për Zhvillimin Rural i Mali të Zi; Rrjeti për Zhvillimin Rural i Maqedonisë; Rrjeti për Zhvillimin Rural i BiH – Bosnja dhe Hercegovina; Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Shqipëri; Rrjeti i Organizatave për Zhvillimin Rural të Kosovës; Rrjeti Kroat për Zhvillimin Rural; dhe Forumi Rural i Letoni-së

më 17 nëntor 2017, u hap dhe Thirrja për Projekte të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri. Thirrja do të qëndrojë e hapur deri më 17 dhjetor 2017, ora 23:59.

Me qëllim promovimin, prezantimin dhe informimin mbi thirrjen, objektivat e saj, si dhe udhëzime të nevojshme për aplikuesit, IDM Albania organizon më **05 dhjetor 2017**, Sesion informimi me organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri.

Sesioni i Informimit do të ofrojë një përshkrim të përgjithshëm të Programit të Grantit për Ngritjen e Kapaciteteve të Shoqërisë Civile dhe Advokimin, do të prezantojë Thirrjen për projekt-propozime, si dhe parashikon një hapësirë kohore për të drejtuar pyetjet e juaja dhe të merrni përgjigje sqaruese për të gjithë procesin.

Sesioni i informimit do të mbahet më **05 dhjetor 2017**, ora **10:00** në ambientet e **Qendrës së Informimit të BE-së në Tiranë**.

Jeni të lutur të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në event, brenda datës 04 dhjetor 2017.

Ju lutem konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: info@idmalbania.org / info@anrd.al

Për më shumë informacion rreth Thirrjes për Projekt-propozime ju ftojmë të vizitoni faqen e internetit: www.idmalbania.org / www.anrd.al

Me respekt,
Stafi IDM Albania